

URDHËR
Nr. 62, datë 17.9.2015

**PËR SHPALLJEN E STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT
TË OJF-VE DHE ZBATIMIN E DETYRUESHËM TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të vendimit nr. 2, datë 27.7.2015 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve, sipas materialeve përkatëse bashkëngjitur.
2. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të OJF-ve bëhet i detyrueshëm për zbatim prej datës 1 janar 2016.
3. Deri në datën e zbatimit, me përdoruesit e tyre, të organizohen seminare dhe trajnime në nivel kombëtar dhe lokal.
4. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të OJF-ve të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.
5. Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani